

VENDIM
Nr.151, datë 18.3.2004

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.333, DATË 29.5.2003 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË
SË SHTETIT"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 63 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit", të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë" dhe të nenit 10 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004", me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.333, datë 29.5.2003 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Në pikën 1, lidhja nr.1 "Niveli i pagës bazë për gradë, sipas roleve për punonjësit e Policisë së Shtetit", zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Në pikën 5, pas fjalëve "...e pagave të Ministrisë së Rendit Publik" të shtohen "...dhe vendimi nr.429, datë 11.6.2001 i Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të Policisë Gjyqësore", i ndryshuar...".

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, në shumën 9980 mijë lekë, të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohen Ministri i Rendit Publik dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 16.2.2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Niveli i pagës bazë për gradë, sipas roleve për punonjësit e Policisë së Shtetit

Lidhja nr.1

Roli	Grada	Paga bazë (për gradë)	Shtesa për natyrë të veçantë pune e shërbimi			
			Në funksione të policisë.....	Në funksione operuese N.shpejtë	Në funksione operuese F.speciale	Në funksione të forc.së posaçme dhe Of.Pol.Gjyq. pranë prokurorisë për krimet e rënda
1	2	3	4	5	6	7
Bazë	Agjent	24800	4000	7000	30000	
	Agjent i I-rë	25800	4000	7000	35000	
	Asistent	26800	4000	8000	42000	
	Asistent i I-rë	27800	4000	8000	44000	
	Kryeasistent	28800	4000	8000	44000	
I Mesëm	Nëninspektor	37000	4000	6000	38000	18500
	Inspektor	39000	4000	6000	38000	19500
	Kryeinspektor	44000	4000	6000	38000	22000
I Lartë	Nënkomisar	54000	4000	6000	31000	27000
	Komisar	67000	4000	6000	31000	33500
	Kryekomisar	77000	4000	6000	31000	
Madhor	Drejtues	87000	8000	10000		
	Zv/Drejtues	103000	15000			
	Drejtues i Përgjithshëm	124500	20000			